

AKTI I THEMELIMIT DHE
STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“KIVEDA POLIURETHAN” SH.P.K

KREU I

Dispozita te Pergjithshme

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “KIVEDA POLIURETHAN”SH.P.K eshte krijuar sipas statutit dhe Aktit te themelimit te perpiluar dhe nenshkruar nga ortaket e saj :

Z. Antonio D’Alba me 50 % te kapitalit

Zj. Asel Petro me 25% te kapitalit

Z. Enri Voci me 25% te kapitalit

Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte “KIVEDA POLIURETHAN ” SH.P.K

Neni 3

Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesve te saj.

Neni 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “KIVEDA POLIURETHAN” SH.P.K ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te themeluesit dhe te punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Neni 5

Shoqeria “KIVEDA POLIURETHAN” SH.P.K eshte person juridik shqiptar, dhe fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit ne organet perkatese.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj, kontraten dhe ne kete statut.

Neni 6

Selia e shoqerise “KIVEDA POLIURETHAN” SH.P.K. eshte ne Shijak, Lagja popullore, zona kadastrale nr.3369 nr pasurie 7/194 ndertese private

Neni 7

Administrator i shoqerise eshte **z. Antonio D’Alba.**

Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen : **Shoqeria “KIVEDA POLIURETHAN” SH.P.K Durrës.**

Neni 9

Shoqeria ka per objekt :

- Prodhim i kepuceve dhe te aksesoreve prej poliuretani per kepuce, nen Regjimin e Perpunitimit aktiv dhe per vete.
- Import-Export te mallrave te ndryshem.

Neni 10

Shoqeria ushtron veprimtarine e vet te perçaktuar ne kete statut ne territorin e Republikës së Shqipërisë. Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te çele dege, zyra dhe filiale te saj te perfaqesimit brenda dhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku eshte hapur.

Neni 11

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

Neni 12

Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

Ata nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tek kapitali themelor ku ata kane marre pjese.

Neni 13

Ortaket kane keto te drejta kryesore :

- Te marre pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise, ne perputhje me kontraten dhe statutin vete ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
- Te marre pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne cdo forme dhe sasi qofte ne perputhje me statutin dhe kontraten.
- Te marre pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen, nepermjet perfaqesuesit te tij ose vete.
- Te kerkoje ti jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen tregtare te shoqerise si dhe te gjitha dokumentet e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.
- Te beje propozime dhe ti paraqese ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeroje dhe shkarkoje perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.
- Te heqe dore nga shoqeria. Heqja dore nga shoqeria nuk liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.

Neni 14

Ortaket kane keto detyra kryesore :

- Te marre pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tij, vete ose nepermjet perfaqesuesve qe krijon ai.

- Ti jape shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

KREU II

Kushtet ekonomike

Neni 15

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te veprimtarise kontabel dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

Neni 16

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000(dhjetemije) leke, i perbere nga 3(tre) kuota:

Z. Antonio D'Alba zoterues i 1 (nje) kuote me vlere 5.000 leke

Zj. Asel Petro zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere 2.500 leke

Z. Enri Voci zoterues i 1 (nje) kuote me vlere 2.500 leke

Neni 17

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te saj ortakët kane te drejten e rritjes se tij ne menyre proporcionale.

Neni 18

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve dhe paraardhesve e pasardhesve.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

Neni 19

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

Neni 20

Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

Shoqeria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj, mbulohen nga fondi rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumet suplementare qe kur deshirojne mund te derdhen prej ortakut, ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

KREU III

Viti financiar, llogarite vjetore, ndarja e fitimit.

Neni 21

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ne ditën e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon me 31 dhjetor te vitit 2024.

Neni 22

Llogarite vjetore, inventari, raportet, operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 3 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 23

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si dhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj, e perfitojne ortakët e shoqerise.

Neni 24

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

KREU IV

Administrimi

Neni 25

Ortakët i perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se tij te derdhur ne formen e kapitalit themeltar.

Neni 26

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga Administratori, eksperti kontabel i autorizuar ose likuiduesi.

Neni 27

Vendimet e asamblese se ortakeve merren me shumice te zakonshme ose shumice te cilesuar.

Cdo kuote e zoteruar eshte e barabarte me nje vote. Ky kriter vlen edhe per kuotat e zoteruara ne bashkepronësi. Vendimet e marra me shumice te zakonshme konsiderohen te vlefshme kur ne mbledhjen e asamblese marrin pjese ortakët me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30%te kuotave dhe vendimi merret nga me shume se gjysma e ortakeve pjesemarres. Vendime e marra me shumice te cilesuar konsiderohen te vlefshme kur ne mbledhjen e asamblese marrin pjese ortake me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50% te kuotave dhe vendimi merret nga 3/4 e votave te ortakeve prezent.

Asambleja e pergjithshme vendos me ¾ e votave te ortakeve pjesemarres per ndryshimin e statutit ,zmadhimin ose zvogelimin e kapitelit te regjistruar shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Ushtrimi i te drejtes se votes per ortakët jo te pranishem ne asamble behet me shkrese ose nepermjet mjeteve te komunikimit elektronik me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakut votues.

Neni 28

Administrimi i shoqerise behet nga Administratori. **Ne shoqerine "KIVEDA POLIURETHAN " SH.P.K administrator eshte z. Antonio D'Alba,** I cili emerohet ne kete post me miratimin e ortakut te shoqerise dhe gjithashtu ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine e saj.

Neni 29

Administratori emerohet per nje **kohezgjatje 5(pese) vjecare** me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha

kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektivin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkeljet e ligjeve, te statutit, apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise

Neni 30

.Te drejtat e administratorit ne shoqeri jane :

Te drejtat e administratorit ne shoqeri jane :

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te beje propozimet e nevojshme ne mbledhjet e asamblese, kur lind nevoja e ndryshimit te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te miratoje aktet normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijojte organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektiveve te shoqerise.
- Te propozojte ne mbledhjen e asamblese per krijimin e njesive, strukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatise propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqese ato asamblese per miratim.
- Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likuidimit dhe te paraqese propozimet per miratim ne asamble.
- Te siguroje zbatimin e perpikete te vendimeve te asamblese.

Neni 31

Kontrolli i shoqerise mund te kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhje. Ai caktohet nga ortaket e shoqerise. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ose kur behet e pamundur kryerja e detyreve.

KREU V

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise.

Neni 32

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet mbi dhjete vjet.

KREU VI

Marredheniet e punes

Neni 33

Mareveshja e punes ne shoqeri rregullohet ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionin shqiptar dhe me kete statut.

Neni 34

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet ne baze te kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje :

- Kushtet dhe menyra e marredhenieeve ne pune.
- Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tyre ne vendin e punes.

- Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes.
- Puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.
- Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.
- Pushimet dhe mungesat.
- Te drejtat detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.
- Paga e punes se punonjesve, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Neni 35

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj, ne organet perkatese, duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 36

Per te gjitha mosmarreshjet, qe mund te lindin, gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Shkalles se Pare

KREU VII

Mbyllja e Shoqerise

Neni 37

Veprimtaria e shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne aktin e themelimit. Veprimtaria e shoqerise mund te mbyllet edhe kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshem veprimtaria e shoqerise nuk rezulton rentabel, ose kur ortaket heqin dore nga shoqeria.

Neni 38

Kur shoqeria likuidohet asamblea mbledh komisionin e likuidimit i cili paraqet per miratim bilancin e likuidimit te shoqerise.

Shoqeria i jep fund veprimtarise ne castin e miratimit te bilancit te likuidimit.

Neni 39

Mjetet financiare si dhe cdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise kur shoqeria likuidohet, i takojne ortakeve ,sipas perqindjeve te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar te secilit, pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjithë kreditoret e shoqerise.

KREU VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 40

Te gjitha veprimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahen ne seline e shoqerise

Neni 41


Ky statut dhe Akt-Themelim eshte hartua sot me daten 07/02/2024 per shoqerine "KIVEDA POLIURETHAN" SH.P.K dhe u nenshkrua prej ortakeve.

ORTAKET E SHOQERISE

Antonio D'Alba



Asel Petro



Enri Voci

